



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

SENATI AKADEMIK

Nr. 244 prot.

Shkodër, më 19, 12 2024

V E N D I M

Nr. 280, datë 19. 12. 2024

"Për disa ndryshime në Rregulloren e Studimeve në Universitetin e Shkodrës"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 38, pika 1, germa d; Statutit të USH-së Neni 17, pika 6, germa r; Rregullores së studimeve në USH, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2024

Vendosi:

1. Të shtojë në nenin 4, pas pikës 2, të Rregullores së Studimeve, pikën 2.1, si vijon:

"2.1 Pezullimi i afatit të studimeve"

Studenti mund të pezullojë studimet në çdo kohë të vitit për këto raste:

- a. kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport komisioni mjeko-ligjor;
- b. në raste fatkeqësishë familjare dhe/ose kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara këto nga zyrat përkatëse të pushtetit vendor;
- c. kur dënohet me burgim për një vepër penale, sipas parashikimeve të Kodit të Procedures Penale;
- d. në rastet kur studentin ndjek studime e kualifikime në institucione të tjera të arsimit të lartë të huaj, me perjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Rregullore.
- e. në çdo rast tjetër i cili sipas vlerësimit të Dekanit dhe Rektorit përbën shkak të ligjshëm dhe objektiv për pezullimin e studimeve.

2.1.1 Kohëzgjatja maksimale e periudhës së pezullimit të studimeve është jo më shumë se 3 vite akademike, duke filluar nga e nesërja e miratimit të pezullimit sipas procedurës së përcaktuar.

2.1.2 Kërkesa për përfitimin e të drejtës së pezullimit të studimeve bëhet me shkrim nga vetë studentin i interesuar, i cili ka detyrimin ta mbështesë me dokumentacionin provues.

2.1.3 Miratimi përfundimtar i kërkesës për pezullimin e afatit të studimeve kryhet nga Rektori i USH-së, pas dhënies së miratimit paraprak nga drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse.

2.1.4 Rikthimi i studentit, pas pezullimit të afatit të studimeve bëhet në fillim të vitit akademik, por jo më vonë se një muaj pas përfundimit të afatit 3- vjeçar.

2.1.5 Studentit që ka pezulluar studimet, i njihen të gjitha detyrimet e shlyera më parë. Ai i nenshtrohet detyrimeve të planit mësimor që gjen pas rifillimit të studimeve.

2.1.6 Gjatë periudhës së pezullimit, afatet e përcaktuara për kohëzgjatjen maksimale të afatit të studimeve, ndërpriten.”

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Tonin GJURAJ

